

## MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në bazë të nenit 33 paragrafi (3), nenit 34 paragrafi (3), nenit 60 paragrafi (3) dhe nenit 61 paragrafi (3) të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme ('Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut' nr. 161/19), ministri i Arsimit dhe Shkencës ka miratuar

### RREGULLORE

#### PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR PËRPARMIN NË TITULL MËSIMDHËNËS-MENTOR, MËSIMDHËNËS-KËSHILLTAR, BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL-MENTOR DHE BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL-KËSHILLTAR

##### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet forma dhe përmbajtja e formularit të kërkesës për përparim në titull Mësimdhënës-Mentor, Mësimdhënës-Këshilltar, Bashkëpunëtorë Profesional-Mentor dhe Bashkëpunëtorë Profesional-Këshilltar.

##### Neni 2

Formulari i kërkesës nga neni 1 i kësaj rregulloreje, plotësohet në aplikacionin elektronik në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Formulari nga paragrafi 1 i këtij neni, i përmban këto të dhëna:

- emri dhe mbiemri i kërkuesit;
- shkolla ku punon dhe komuna;
- vendi i punës ku është i punësuar me kohë të pacaktuar;
- titullin për të cilin aplikon;
- titulli paraprak;
- përvoja e punës;
- lloji i arsimimit;
- trajnimet, konferencat shkencore-profesionale, kongreset, simpoziumet, autorësia, pjesëmarrjet në aktivitete për përmirësimin e mësimdhënies, çmimet dhe mirënjohjet;
- praktika profesionale për kompetencat e fituara.

Për të dhënat e paragrafit 2 alineja 3,5,6,7,8 dhe 9 nga ky nen, kërkuesi në aplikacionin elektronik në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, bashkëngjijt provat përkatëse në formë elektronike.

##### Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën pas publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**Nr.18-4808/1**  
**5 maj 2020**  
**Shkup**

**ministër i Arsimit dhe Shkencës**  
**Arbër Ademi nënshkrimi me d.v.**